

VENDIM
Nr. 174, datë 29.8.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAETHON” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.8.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/17 prot., datë 27.8.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Faethon’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Faethon” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 93 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 104, datë 31.5.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 4.6.2024 dhe 5.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve, apo të objeksioneve, nga të tretët (data 3.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 1481 prot., datë 6.6.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure. Ndërsa me shkresën nr. 1125/3 prot., datë 4.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar plotësimin e informacionit/dokumentacionit të konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar nga shoqëria, ka rezultuar se ka ende dokumentacion të paplotësuar, ndaj me vendimin nr. 155, datë 31.7.2024, Bordi i ERE-s vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë vendimarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “Faethon” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Pas seancës dëgjimore të mbajtur në ambientet e ERE-s, në datën 15.8.2024 dhe korrespondencës së zhvilluar në vijim me shoqërinë, rezulton se ajo ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, konkretisht, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1, gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”, si dhe ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të kësaj rregulloreje.

- Rezulton se shoqëria “Faethon” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n, kontratën nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 5.4.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 93 mw, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, nga shoqëria ‘Faethon’ sh.p.k.”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiik Libohovë”, në datën 3.6.2024, për lidhjen e parkut fotovoltaiik Libohovë me fuqi të instaluar prej 78.6 mw AC me rrjetin 110 kV të transmetimit;

- Është pajisur me Deklaratë Mjedisore, lëshuar më datë 4.10.2023, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin për ndërtimin e parkut fotovoltaiik në Libohovë, me fuqi të instaluar 93 mw.

- Aktualisht, shoqëria ka një Deklaratë Mjedisore të Vlefshme (deri më 4.10.2025) dhe ka njoftuar se nuk ka filluar ende punimet, pasi është në proces të marrjes së lejes së ndërtimit. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht asaj që të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 4.10.2025, që është dhe afati i fundit i vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore, afat i cili është brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE-n.

- Në nenin 9 të Rregullores, pika 2.1 kërkon që për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu, formatin e plotësuar me të dhënat teknike sipas shtojcës 2 të Rregullores dhe duke iu referuar gërmës “a”, pikës 2, shoqëria ka plotësuar se kapaciteti i instaluar do të jetë 78.6 mw AC, si dhe duke iu referuar marrëveshjes me rrjetin e transmetimit për lidhjen e parkut fotovoltaiik Libohovë, me fuqi të instaluar prej 78.6 mw AC me rrjetin 110 kV të transmetimit, të lidhur ndërmjet shoqërisë dhe OST sh.a. vlerësojmë se shoqëria duhet të licencohet për fuqinë e instaluar 78.6 mw AC.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 5, pika 1, germa “a” të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Në rastet analoge ka rezultuar që një central fotovoltaiik e ka jetëgjatësinë 25 ose 30 vjet, në varësi të garancisë së paneleve të përdorura. Duke qenë se shoqëria nuk ka paraqitur një dokument teknik, në lidhje me jetëgjatësinë e centralit, vlerësohet që licenca të jepet për një afat 25-vjeçar, afati i cili do të fillojë në përputhje me afatet e përcaktuara në VKM-në nr. 67/2024 dhe në kontratën me MIE-n për vënien në punë të parkut fotovoltaiik, pra jo më vonë se data 14.2.2027.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Faethon” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 78.6 mw AC, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, qarku Gjirokastrë, për një afat 25-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 14.2.2027.

3. Shoqëria “Faethon” sh.p.k., të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 4.10.2025

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Faethon” sh.p.k., shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” sh.a. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund

ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti